



Kodi i mirësjelljes në shkollën e kurseve “U R A”

Kodi i mirësjelljes për studentët dhe klientët e shkollës së kurseve “URA”:

Të gjithë studentët dhe klientët tjerë të shkollës së kurseve “U R A” janë të obliguar të respektojnë rregullat tona të brendëshme, të cilët janë si në vijim:

- 1. Vijimi i rregullt i mësimit sipas orarit të përcaktuar nga administrata e shkollës, mungesat dhe vonesat e paarsyeshme nuk tolerohen.*
- 2. Respektimi i mësimdhënësit, punëtorëve në administratë dhe secilit në shkollë.*
- 3. Ngacmimet dhe përqeshja janë rreptësisht të ndaluara. Për neve secili ka dhe është një vlerë në vete.*
- 4. Përgatitja për mësim dhe të qenurit i pajisur gjithmonë me materialin për mësim.*
- 5. Ti vihet kujdes inventarit, higjienës dhe mjedisit në shkollë.*
- 6. Të mos manifestohen sjellje të këqija, si përqeshje, ngacmime etj. ndaj studentëve dhe personelit në shkollë.*
- 7. Të mos frekuentohet kursi nën ndikimin e alkoholit dhe drogave.*
- 8. Të mos përdoret celulari në orën mësimore, për çështje private.*
- 9. Të mos kopjohet gjatë testimeve dhe provimeve.*
- 10. Debatet dhe diskutimet nuk guxojnë të kenë karakter politik, fetar, racor apo ndëretnik, përveq nëse kjo kërkohet përmes kurrikulës dhe në suayat e korniyave të saj.*
- 11. Të mos përdoret ushqimi në klasë.*
- 12. Pagesat bëhen me rregull (brenda pesë ditëve të para të fillimit të muajit).*
- 13. Për mosvijueshmërinë e kursit, shkolla nuk është e obliguar të rimburoj pagesën e bërë.*
- 14. Konsumimi i duhanit bëhet vetëm në vendin e caktuar, tymosja në vende të tjera është rreptësisht e ndaluar*
- 15. Për të gjitha pakënaqësitë eventuale ndaj stafit, secili/a është i/e inkurajuar të shpreh ankesat e tij/saj në mënyrë anonime (ose edhe me emër e mbiemër) në kutinë e ankesave. Ato do të trajtohen me kujdes*



Kodi i mirësjelljes për personelin e shkollës së kurseve „URA“:

1. *Secili mësime fillon mësimin me kohë dhe e përfundon atë në orarin e përcaktuar që më parë.*
2. *Vonesat dhe mungesat eventuale duhet të lajmërohen paraprakisht në administratën e shkollës.*
3. *Orët e mësimit përgatiten më parë dhe ligjërimi duhet të mbulojë tërë kohën e paraparë.*
4. *Komunikimi me studentë ka karakter zyrtar dhe çdo komunikim tjetër është jashtë rendit shtëpiak të shkollës dhe si i tillë sanksionohet.*
5. *Mësime dhe personeli tjetër nuk i provokojnë studentët, as verbalisht e as me veshjet e tyre.*
6. *Grupet virtuale me studentë formohen nga administrata e shkollës dhe menaxhohen nga personeli i administratës.*
7. *Të gjitha njoftimet për vijueshmërinë e kursit kryhen përmes administratës së shkollës.*
8. *Secili është i obliguar të ruaj konfidencialitetin zyrtar të shkollës, bartja e informacioneve jashtë konsiderohet si jolojalitet ndaj shkollës.*
9. *Për qështje të hapura, ngecje, këshilla eventuale etj. që kanë lidhje me mësime dhe pedagogjinë e shkollës, secili është i obliguar të bie në kontakt me profesorin e gjuhës gjermane, Neki Jahaj, i cili është i obliguar të caktoj një termin të përshtatshëm për këshillime.*
10. *Emrat e kandidatëve të cilët i nënshtrohen provimeve dorëzohen gjithmonë në administratë.*
11. *Secili mësime është i obliguar të përcjell pakënaqësitë e studentëve dhe t'i lajmëroj ato me shkrim në administratën e shkollës.*
12. *Ndalohet përdorimi i celularit për nevoja private gjatë orës mësimore.*
13. *Mësime mban përgjegjësi për materialin mësimor, inventarin si dhe pajisjet elektronike. Për defektet eventuale gjithmonë lajmërohet administrata.*
14. *Pagesat e kursantëve parimisht mblidhen nga administrata. Në raste shumë të veqanta administrata mund të autorizoj mësime për mbledhjen e pagesave.*
15. *Mësime mban evidencë ditore për vijimin e kursit nga studentët. Listat e pjesëmarrjes në kurs dorëzohen gjithmonë në fund të secilës javë.*
16. *Qasja në kompjuterin kryesor të shkollës bëhet vetëm me prezencë të punëtorit/punëtores së administratës.*
17. *Aparati fotokopjues është në shfrytëzim për secilin mësime. Prishja ose mosfunksionimi i tij duhet të lajmërohet menjëherë në administratën e shkollës.*
18. *Secili mësime është i obliguar t'i njoftoj studentët e vet për rregullat e brendëshme.*
19. *Secili mësime respekton rregulloren antikovid, të hartuar dhe miratuar në shtator të vitit 2020, e cila është obligative deri në shpalljen e përfundimit të Pandemisë me Covid 19.*